

AKT NORMATIV
Nr. 38, datë 31.12.2020

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE DHE MINISTRIT TË SHËTETIT PËR RINDËRTIMIN PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE ME PRODHUESIT E VAKSINËS ANTICOID-19, TË CILËT JANË TË CERTIFIKUAR NGA DEPARTAMENTI AMERIKAN I USHQIMIT DHE BARNAVE (FDA) DHE/OSE AGJENCIA EVROPIANE E BARNAVE (EMA), PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME KËTË VAKSINË

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dhënie autorizimi për zhvillimin e negociatave

Dhënien e autorizimit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin për zhvillimin e negociatave me prodhuesit e vaksinës Anticovid-19, të cilët janë të certifikuar nga Departamenti Amerikan i Ushqimeve dhe Barnave (FDA) dhe/ose Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me këtë vaksinë, sipas kushteve më të favorshme për Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama